

Vendim nr. 250 datë 09.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 09.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (T) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **TASIM MEÇE,** përfaqësuar nga avokatët Iljan Qeshi dhe Eno Bezati, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2195, datë 27.10.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2025-505, datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të babait të tij, pretendon se me anë të trashëgimisë ligjore dhe dhurimit nga trashëgimtarët e tjerë ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme (ndërtesë dhe oborr me sipërfaqe rreth 1000 m²), të ndodhur në Tiranë. Nga ana tjetër, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) në Bashkinë e Tiranës në vitin 1995 ka njohur të drejtën e pronësisë mbi pronën dhe i ka kthyer një pjesë të truallit subjektit të shpronësuar (kunata e babait të kërkuesit).

2. Me pretendimin se vendimi i KKKP-së ishte në kundërshtim me ligjin, kërkuesi ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 4701, datë 08.06.2015, ka rrëzuar padinë, me arsyetimin se KKKP-ja ka disponuar në favor të subjektit të shpronësuar nga shteti në ushtrim të kompetencës së saj.

3. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2195, datë 27.10.2016, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-505, datë 12.02.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të tij.

4. Në datën 10.07.2025, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 5.1. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi babait të tij i është njohur e drejta e pronësisë me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe gjykatat nuk i kanë kthyer përgjigje lidhur me këtë pretendim dhe nuk i kanë shpjeguar se përse nuk ka të drejtë.
- 5.2. *E drejta për akses në kuptimin substancial*, pasi Gjykata e Lartë në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit duhet t'u jepte përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të ngritura prej tij, duke pamundësuar në këtë mënyrë aksesin në gjykatë, duke ulur besueshmërinë dhe anashkaluar pasojat që sjell vendimi përfundimtar i formës së prerë.
- 5.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat kanë dhënë një arsyetim kontradiktor, të paplotë dhe të paargumentuar, duke anashkaluar vlerësimin e

provave të çështjes. Anashkalimi i vlerësimit dhe arsyetimit të çështjes ka çuar në një vendimmarrje të gabuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë paditëse në çështjen gjyqësore në të cilën janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

8. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

9. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 09.04.2025, ndërsa ankimi individual është paraqitur në Gjykatë në datën 10.07.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

10. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e sigurisë juridike, aksesit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, mbështetur në argumentet se gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të tij, duke anashkaluar faktin se për pasurinë objekt gjykimi ka një

vendim gjyqësor të formës së prerë me palë kundërshtare që i njeh trashëgimlënësit (babait të tij) të drejtën e pronësisë, të disponuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 05.04.1994, përpara vendimit të KKKP-së. Referuar thelbit të këtyre argumenteve, Kolegji çmon t'i analizojë ato në këndvështrim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me sigurinë juridike dhe aksesin substancial*.

11. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pranuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 3, datë 20.01.2017; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë rrëzuar padinë e kërkuarit, me të cilën ai ka kundërshtuar vendimin e KKKP-së, që ka disponuar njohjen e pronësisë së truallit me sipërfaqe 1350 m² subjektit të shpronësuar (kunata e babait të kërkuarit). Gjykatat e faktit kanë arsyetuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë i datës 05.04.1994, me të cilin është njohur e drejta e pronësisë së trashëgimlënësit (babait të kërkuarit), edhe pse formalisht është me palë kundërshtare (paditës trashëgimlënësi dhe i paditur seksioni i financës së bashkisë), në thelb, ka karakter njohës dhe nuk mund të shtrijë efektet juridike mbi palët që nuk kanë marrë pjesë në gjykim, pra mbi personat e tretë për të cilët ka disponuar KKKP-ja. Sipas tyre, bazuar në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile, vendimi gjyqësor në fjalë është i detyrueshëm vetëm për çfarë është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Përderisa ky vendim nuk i kundërdrejtohet pronares së shpronësuar ose trashëgimtarëve ligjorë të saj, por në kontekstin e ligjit të kohës ka të paditur seksionin e financës së Bashkisë së Tiranë dhe është realizuar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë nga babai i kërkuarit, pra vendim njohjeje, nuk mund të cenojë si i tillë të drejtën e pronësisë së pronarit të

shpronësuar të pajisur me dokumente pronësie (*shih faqen 11 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*). Nëse kërkuesi pretendon se ky vendim gjyqësor është prova themelore që provon pretendimin e tij, e vetëmjaftueshme për cilësinë e të qenurit pronar, ai nuk kishte as pse ta kundërshtonte vendimin e KKKP-së (*shih paragrafët 19 dhe 20 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Ky arsyetim është gjetur i bazuar në ligj nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se për sa u përket efekteve të vendimit gjyqësor të datës 05.04.1994, me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës së babait të kërkuesit dhe njohja pronar i pasurisë, që për shkak të kufijve të shqyrtimit, bazës provuese dhe palëve ndërgjyqëse, përfaqëson një vendim të natyrës njohëse (*shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

13. Në analizë të arsytimit të këtyre vendimeve, Kolegji çmon se gjykatat i kanë dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit për sa i takon situatës lidhur me vendimin gjyqësor të datës 05.04.1994. Në vlerësimin e Kolegjit, përfundimi i arritur nga gjykatat në vendimet objekt kundërshtimi nuk duket i paarsyeshëm, në kushtet kur e drejta e pronares së shpronësuar është njohur, kthyer dhe kompensuar bazuar në aktet e pronësisë që ajo ka disponuar në emër të saj. Njohja e pronësisë është bazuar në parashikimet e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, i cili për realizimin e procesit krijoi edhe organet përkatëse. Nën këtë optikë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe së drejtës së aksesit substancial është haptazi i pabazuar.

14. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.